

OGP Commitment Template

Country	Shqipëri
Number and Name of the Commitment	1. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorët vulnerabël dhe forcimi i bashkëpunimit publik-privat për ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave parandalues në luftën kundër korrupsionit. 2. Përmirësimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile për rritje të ndikimit të integritetit dhe transparencës në vendimmarrjen publike. 3. Zbatimi i kurrikulës së integritetit dhe rritja e informimit për luftën kundër korrupsionit, në institucionet e arsimit parauniversitar.
Brief Description of the Commitment	Commitment 1: Ky angazhim synon të forcojë qasjen parandaluese ndaj korrupsionit përmes identifikimit dhe menaxhimit të risqeve në sektorët më vulnerabël, të identifikuar në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit, 2024-2030, si dhe përmes rritjes së bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat. Në këtë kuadër, angazhimi parashikon zhvillimin dhe zbatimin e metodologjive për vlerësimin e riskut të korrupsionit, hartimin dhe publikimin e planeve të integritetit në institucionet publike, si dhe forcimin e mekanizmave të transparencës dhe integritetit në marrëdhëniet publik–privat. Përmes krijimit të platformave të dialogut dhe organizimit të aktiviteteve të përbashkëta me sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile, ky angazhim synon të përmirësojë koordinimin ndërinstitutional, të rrisë ndërgjegjësimin dhe të promovojë standarde të qëndrueshme integriteti në praktikën institucionale dhe ekonomike. Commitment 2: Ky angazhim synon të përmirësojë transparencën dhe integritetin në proceset e vendimmarrjes publike, si dhe të forcojë ndëreveprimin ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile. Në këtë kuadër, angazhimi parashikon krijimin dhe institucionalizimin e mekanizmave të konsultimit me palët e interesit, si dhe zhvillimin dhe zbatimin e instrumenteve për vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike (<i>corruption proofing</i>), me qëllim identifikimin dhe parandalimin e risqeve të korrupsionit në vendimmarrje. Gjithashtu, angazhimi synon të rrisë transparencën përmes publikimit të të dhënave dhe informacionit mbi proceset vendimmarrëse, si dhe të forcojë rolin e organizatave të shoqërisë civile në monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike. Nëpërmjet këtyre masave, synohet rritja e llogaridhënies institucionale dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në qeverisje. Commitment 3: Ky angazhim synon të forcojë edukimin për integritetin dhe ndërgjegjësimin kundër korrupsionit në institucionet e sistemit arsimor parauniversitar, si një

	element kyç për ndërtimin afatgjatë të një kulture qytetare të bazuar në etikë dhe përgjegjshmëri. Në këtë kuadër, angazhimi parashikon finalizimin dhe zbatimin e kurrikulës së integritetit, shtrirjen e tyre në klasa të tjera të arsimit para-universitar, zhvillimin e materialeve didaktike dhe trajnimin e mësuesve, si dhe organizimin e aktiviteteve edukative dhe ndërgjegjëse për nxënësit. Përmes këtyre ndërhyrjeve, synohet rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit të të rinjve mbi pasojat e korrupsionit dhe rëndësinë e integritetit, si dhe nxitja e përfshirjes së tyre në çështjet e transparencës dhe qeverisjes së mirë.		
Commitment Lead	Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin Drejtoria e Përgjithshme e Antikorrupsionit		
Supporting Stakeholders	Government	Civil Society	Other Actors (Parliament, Private Sector, etc)
	Ministria e Arsimit Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Drejtoria e Përgjithshme e Doganave Agjencia e Prokurimit Publik Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) Qendra ALTRI AIS (OPEN DATA ALBANIA) AWEN PARTNERS ALBANIA IDRA	Grupe të ndryshme interesi
Period Covered	2026–2030		

Problem Definition

1. What problem does the commitment aim to address?

Commitment 1:

Paralelisht me progresin e zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, dhe të Planit të saj të parë të Veprimit, 2024-2026, institucionet publike në Shqipëri vijnë të përballen me sfida në identifikimin dhe menaxhimin sistematik të risqeve të korrupsionit, veçanërisht në sektorët më vulnerabël dhe ndërveprimi me publikun është më i shpeshtë.

Aktualisht, mungesa e pasjes i metodologjive të standardizuara për vlerësimin e riskut të korrupsionit, si dhe niveli jo i plotë, i zhvillimit dhe zbatimit të planeve të integritetit, kufizojnë efektivitetin e qasjeve parandaluese. Në të njëjtën kohë, bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe atij privat në adresimin e risqeve të korrupsionit mbetet një proces në vijim. Viti 2026, pritet të shënojë vitin kyç në vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe adresimin e masave për ndërhyrje në kuadër të parandalimit.

Këto faktorë ndikojnë në vazhdimësinë e praktikave të ekspozuara ndaj korrupsionit, në uljen e transparencës dhe në kufizimin e mekanizmave efektivë të parandalimit, duke ndikuar negativisht në besimin e publikut ndaj institucioneve.

Commitment 2:

Proceset e vendimmarrjes publike në Shqipëri vijnë të përballen me sfida në drejtim të transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes efektive të palëve të interesit, veçanërisht të organizatave të shoqërisë civile.

Nevoja për përmirësim të mekanizmave të qëndrueshëm për konsultimin dhe përfshirjen e publikut, si dhe niveli i kufizuar i transparencës mbi ndërveprimet ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit, kufizojnë aksesin në informacion dhe mundësinë për mbikëqyrje publike të vendimmarrjes.

Në të njëjtën kohë, nevoja për përmirësim të instrumenteve të strukturuar për vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike ndikon në përmirësimin e besimit të publikut në institucionet shtetërore.

Këto sfida ndikojnë në cilësinë e vendimmarrjes publike dhe në efektivitetin e mekanizmave të transparencës dhe llogaridhënies.

Commitment 3:

Edukimi për integritetin dhe ndërgjegjësimi kundër korrupsionit në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri mbeten në tendencë për përmirësim. Rishikimi i kurrikulës mësimore për klasa të arsimit parauniversitar duhet të përfshijë edhe tjerat përveç klasës së 1, 6 dhe 10.

Aktualisht, përfshirja e koncepteve që lidhen me etikën, integritetin dhe antikorrupsionin është e pjesshme dhe jo e standardizuar në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Gjithashtu, nevoja për shtim të materialeve të strukturuar didaktike dhe e trajnimeve të specializuara për mësuesit ndikon në zbatimin efektiv të këtyre tematikave në praktikën mësimore.

Si rezultat, niveli i ndërgjegjësimit dhe i njohurive të rinjve mbi korrupsionin, pasojat e tij dhe rëndësinë e integritetit mbetet kërkesë e shtuar, gjë e cila nëse adresohet siç duhet ndikon në ndërtimin afatgjatë të një kulture qytetare të bazuar në etikë dhe përgjegjshmëri. Brezat e rinj duhet të arsimohen dhe të kenë njohuritë kryesore për etikën, rregullat e sjelljes në shoqëri dhe besimin tek autoriteti i zyrtarit publik.

2. What are the causes of the problem?

Commitment 1:

Shkaqet kryesore lidhen me nevojën për plotësimin e një qasjeje të standardizuar për vlerësimin e riskut të korrupsionit dhe me kapacitetet e kufizuara institucionale për identifikimin dhe menaxhimin e tij. Në veçanti, planet e integritetit nuk janë të zhvilluara dhe të zbatuara në mënyrë të njëtrajtshme, koordinimi ndërinstytucional ka nevojë për përmirësim dhe bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe atij privat duhet të shtohet.

Commitment 2:

Shkaqet kryesore lidhen me mungesën e mekanizmave të institucionalizuar për konsultimin dhe përfshirjen e palëve të interesit në proceset vendimmarrëse, si dhe me për më shumë transparencë mbi aktivitetin midis autoriteteve publike dhe grupeve të interesit.

Gjithashtu, përdorimi më i shtuar i instrumenteve të strukturuar për vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike, si dhe rritja e organizatave të shoqërisë civile në monitorim, për të pasur vendimmarrje më të drejta.

Commitment 3:

Shkaqet kryesore lidhen me edukimin e integritetit dhe etikës, në përdorimin e ligjit dhe të drejtave që ai na jep, që në sistemin arsimor parauniversitar dhe në kurrikulat e arsimit parauniversitar.

Gjithashtu, më shumë materiale didaktike të strukturuar dhe e trajnimeve të specializuara për mësuesit kufizon zbatimin efektiv të edukimit për integritetin në praktikën mësimore, duke ndikuar në nivelin e ndërgjegjësimit të të rinjve që në moshat e hershme.

Commitment Description

1. What has been done so far to solve the problem?

Commitment 1:

Në kuadër të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030 janë ndërmarrë masa për forcimin e integritetit dhe transparencës në institucionet publike, përfshirë hartimin e planeve të integritetit dhe përmirësimin e kuadrit ligjor në fusha të caktuara.

Gjithashtu, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë ka kontribuar në rritjen e kapaciteteve dhe promovimin e praktikave të mira siç përmendet edhe Metodologjia e Vlerësimit të Riskut të Korrupsionit në sektorin publik.

Commitment 2:

Në kuadër të reformave të ndërmarra për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, janë zhvilluar praktika konsultimi me palët e interesit dhe janë ndërmarrë hapa për përmirësimin e aksesit në informacion dhe përfshirjen e organizatave të shoqërisë civile në procese të caktuara vendimmarrëse. Gjithashtu, janë iniciuar masa për rritjen e transparencës në proceset legjislative dhe në aktivitetet e institucioneve publike, si dhe janë zhvilluar praktika monitorimi dhe raportimi me kontributin e organizatave të shoqërisë civile.

Commitment 3:

Janë ndërmarrë hapa për përfshirjen e elementeve të edukimit ligjor dhe ndërgjegjësimit mbi integritetin në sistemin arsimor parauniversitar, si dhe janë zhvilluar iniciativa ndërgjegjësuese nga institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile. Gjithashtu, janë pilotuar aktivitete dhe programe që synojnë rritjen e njohurive të të rinjve mbi etikën dhe antikorrupsionin.

2. What results do we want to achieve by implementing this commitment?

Commitment 1:

Zbatimi i këtij angazhimi synon të përmirësojë identifikimin dhe menaxhimin e risqeve të korrupsionit në sektorët dhe institucionet prioritare, përmes një qasjeje të standardizuar dhe të zbatuar në mënyrë të qëndrueshme.

Gjithashtu, pritët rritja e transparencës dhe integritetit në institucionet publike, përmes hartimit dhe zbatimit të planeve të integritetit, si dhe forcimi i bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat në parandalimin e korrupsionit.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, synohet rritja e efektivitetit të mekanizmave parandalues dhe përmirësimi i besimit të publikut ndaj institucioneve.

Commitment 2:

Zbatimi i këtij angazhimi synon të rrisë transparencën dhe integritetin në proceset e vendimmarrjes publike, si dhe të forcojë llogaridhënien e institucioneve ndaj qytetarëve.

Gjithashtu, pritët përmirësimi i ndërveprimit ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile, përmes mekanizmave të strukturuar konsultimi dhe përfshirjes aktive në monitorimin e politikave publike.

Nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të instrumenteve për vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike, synohet identifikimi dhe reduktimi i risqeve të korrupsionit në vendimmarrje, si dhe rritja e besimit të publikut në institucionet shtetërore.

Commitment 3:

Zbatimi i këtij angazhimi synon të rrisë nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit të të rinjve mbi integritetin dhe pasojat e korrupsionit, përmes integritetit të qëndrueshëm të këtyre tematikave në sistemin arsimor parauniversitar.

Gjithashtu, pritët përmirësimi i kapaciteteve të mësuesve për të trajtuar temat e etikës dhe antikorrupsionit, si dhe zbatimi i një kurrikule të standardizuar në të gjitha nivelet përkatëse.

Nëpërmjet këtyre ndërhyrjeve, synohet ndërtimi afatgjatë i një kulture qytetare të bazuar në integritet, përgjegjshmëri dhe pjesëmarrje aktive në çështjet e qeverisjes së mirë.

Commitment Analysis

Questions	Answer (if not applicable, just answer with N/A)
1. How will the commitment promote transparency? <i>How will it help improve citizens' access to information and data?</i>	Commitment 1: Ky angazhim do të promovojë transparencën përmes vlersimit të riskut të korrupsionit, zbatimin e planeve të

<i>How will it make the government more transparent to citizens?</i>	integritetit në institucionet publik dhe hartimin e planeve të veprimit sektoriale kundër korrupsionit Nëpërmjet publikimit të raporteve të vlerësimit të riskut dhe planeve të integritetit në format të aksesueshëm për publikun, qytetarët dhe palët e interesit do të kenë mundësi të kuptojnë më mirë risqet e korrupsionit dhe masat e ndërmarra për adresimin e tyre. Gjithashtu, forcimi i bashkëpunimit publik-privat dhe zhvillimi i mekanizmave të dialogut do të rrisin transparencën në marrëdhëniet ndërmjet institucioneve publike dhe sektorit privat, duke kontribuar në një mjedis më të hapur dhe më të besueshëm. Commitment 2: Ky angazhim do të promovojë transparencën përmes rritjes së aksesit të publikut në informacion dhe të dhëna mbi proceset vendimmarrëse dhe ndërveprimet ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit. Nëpërmjet publikimit të të dhënave në format të hapur, si dhe të raporteve të monitorimit mbi integritetin e legjislacionit dhe politikave publike, qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile do të kenë mundësi të ndjekin dhe të analizojnë proceset vendimmarrëse në mënyrë më të informuar. Gjithashtu, rritja e transparencës së aktiviteteve të lobimit dhe e konsultimeve me palët e interesit do të kontribuojë në një vendimmarrje më të hapur, duke forcuar besimin e publikut në institucionet shtetërore. Commitment 3: Ky angazhim do të promovojë transparencën përmes rritjes së informimit dhe ndërgjegjësimit të nxënësve mbi korrupsionin, pasojat e tij dhe rëndësinë e integritetit në jetën publike. Nëpërmjet zbatimit të kurrikulës së integritetit dhe përdorimit të materialeve didaktike të strukturuar, nxënësit do të pajisen me njohuri mbi parimet e transparencës, llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë. Gjithashtu, aktivitetet edukative dhe ndërgjegjësuere në shkolla do të kontribuojnë në krijimin e një baze më të gjerë qytetarësh të informuar dhe të ndërgjegjshëm, të aftë për të kërkuar dhe mbështetur transparencën në institucionet publike.
2. How will the commitment help foster accountability?	Commitment 1: Ky angazhim do të forcojë llogaridhënien përmes vendosjes së mekanizmave më të qartë për monitorimin

How will it help public agencies become more accountable to the public? How will it facilitate citizens' ability to learn how the implementation is progressing? How will it support transparent monitoring and evaluation systems?

dhe raportimin e risqeve të korrupsionit dhe zbatimit të planeve të integritetit në institucionet publike.

Publikimi i raporteve të vlerësimit të riskut dhe i planeve të integritetit do t'u mundësojë qytetarëve dhe palëve të interesit të ndjekin progresin e institucioneve në adresimin e risqeve të korrupsionit dhe në përmirësimin e praktikave të integritetit.

Gjithashtu, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë në monitorimin e zbatimit do të kontribuojë në rritjen e mbikëqyrjes publike dhe në forcimin e përgjegjshmërisë së institucioneve ndaj qytetarëve.

Commitment 2:

Ky angazhim do të forcojë llogaridhënien përmes krijimit të mekanizmave të strukturuar për monitorimin dhe vlerësimin e integritetit në proceset vendimmarrëse. Zhvillimi dhe zbatimi i instrumenteve për vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike do të mundësojë identifikimin e risqeve të korrupsionit dhe do të krijojë një bazë të qartë për mbikëqyrje dhe raportim publik.

Publikimi periodik i raporteve të monitorimit dhe rritja e transparencës së ndërveprimeve ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit do t'u japë qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile mundësinë të ndjekin progresin e zbatimit dhe të kërkojnë përgjegjshmëri nga institucionet.

Gjithashtu, përfshirja aktive e organizatave të shoqërisë civile në proceset e monitorimit dhe vlerësimit do të kontribuojë në krijimin e një sistemi më transparent dhe të besueshëm të llogaridhënies publike.

Commitment 3:

Ky angazhim do të kontribuojë në forcimin e llogaridhënies nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe njohurive të rinjve mbi integritetin, transparencën dhe përgjegjshmërinë në jetën publike.

Zbatimi i kurrikulës së integritetit dhe zhvillimi i aktiviteteve edukative do të ndihmojnë në formimin e qytetarëve të informuar dhe të ndërgjegjshëm, të aftë për të kërkuar llogaridhënie nga institucionet publike.

Gjithashtu, vlerësimi i ndikimit të kurrikulës do të mundësojë ndjekjen e progresit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të ndërhyrjeve, duke kontribuar në një

	qasje më të qëndrueshme dhe të matshme ndaj edukimit për integritetin.
3. How will the commitment improve citizen participation in defining, implementing, and monitoring solutions? <i>How will it proactively engage citizens and citizen groups?</i>	Commitment 1: Ky angazhim do të përmirësojë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit përmes përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile dhe sektorit privat në proceset e identifikimit dhe monitorimit të risqeve të korrupsionit. Nëpërmjet mekanizmave të dialogut publik–privat dhe aktiviteteve të përbashkëta, palët e interesit do të kenë mundësi të kontribuojnë me komente, rekomandime dhe analiza në adresimin e risqeve dhe në përmirësimin e praktikave të integritetit. Commitment 2: Ky angazhim do të përmirësojë pjesëmarrjen qytetare përmes krijimit dhe institucionalizimit të mekanizmave të qëndrueshëm të konsultimit dhe bashkë-krijimit ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile. Nëpërmjet këtyre mekanizmave, qytetarët dhe grupet e interesit do të kenë mundësi të kontribuojnë në mënyrë aktive në hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave publike, duke ofruar komente, rekomandime dhe analiza të pavarura. Gjithashtu, përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në proceset e monitorimit dhe vlerësimit të integritetit të legjislacionit dhe vendimmarrjes publike do të forcojë rolin e tyre si aktorë kyç në mbikëqyrjen publike. Commitment 3: Ky angazhim do të përmirësojë pjesëmarrjen qytetare përmes rritjes së përfshirjes së të rinjve në çështjet e integritetit, transparencës dhe qeverisjes së mirë. Nëpërmjet zbatimit të kurrikulës së integritetit dhe aktiviteteve edukative në shkolla, nxënësit do të inkurajohen të zhvillojnë mendim kritik dhe të angazhohen në mënyrë aktive në diskutime dhe iniciativa që lidhen me etikën dhe antikorrupsionin. Gjithashtu, aktivitetet ndërgjegjëse dhe praktikatat edukative do të krijojnë mundësi për përfshirjen e të rinjve si qytetarë aktivë, duke kontribuar në ndërtimin e një baze më të gjerë pjesëmarrjeje në çështjet e qeverisjes publike në të ardhmen.

Commitment Planning

(This is an initial planning process largely looking at milestones and expected outputs, as well as key stakeholders involved.)

Milestones <i>(Milestones are part of a series of actions or events that, when executed, will lead to the achievement of the result the commitment would like to achieve.)</i>	Expected Outputs <i>(Outputs are concrete, objectively-verifiable results that are direct products of activities conducted or implemented.)</i>	Expected Completion Date	Stakeholders		
1. Vlerësimi i riskut të korrupsionit në sektorët vulnerabël dhe forcimi i bashkëpunimit publik-privat për ngritjen dhe përmirësimin e mekanizmave parandalues në luftën kundër korrupsionit					
1. Identifikimi i sektorëve dhe institucioneve prioritare për vlerësimin e riskut të korrupsionit, në përputhje me SNKK 2024 - 2030. 2. Zhvillimi dhe/ose përditësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut të korrupsionit në institucionet publike dhe sektorët vulnerabël (metodologji sektoriale) 3. Kryerja e vlerësimeve të riskut të korrupsionit në sektorët dhe institucionet e identifikuar.	Institucioneve dhe autoritete publike të identifikuar në përputhje me sektorët në njohur nga SNKK; Metodologji e standardizuar, sektoriale, për vlerësimin e riskut e miratuar; Raporte të vlerësimit të riskut të korrupsionit të publikuara;	2026 -2027	Lead: MAPA - DPAK		
			Supporting Stakeholders		
			Governme nt	CSOs	Others (e.g., Parliame nt, Private Sector etc)
			MAPA DPAK MA MSHMS DPT DPD APP 	IDM + OSHC të tjera	Asistenca teknike të huaja

4. Hartimi, miratimi dhe publikimi i planeve të integritetit në institucionet përkatëse, përfshirë ndërmarrjet shtetërore.	Plane integriteti të miratuara dhe të publikuara në format të hapur;				
5. Krijimi dhe funksionalizimi i mekanizmave të dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat për integritetin në biznes.	Platformë ose mekanizëm funksional dialogu publik–privat;				
6. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta (forume, tryeza, konsultime) për promovimin e standardeve të integritetit në marrëdhëniet publik–privat.	Raporte ose rekomandime nga aktivitetet e bashkëpunimit publik–privat.				

2. Përmirësimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile për rritje të ndikimit të integritetit dhe transparencës në vendimmarrjen publike

1. Krijimi dhe institucionalizimi i mekanizmave të rregullt dhe të strukturuar të konsultimit ndërmjet autoriteteve publike dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse.	Takime, forume, tryeza konsultimi me OSHC;	Përgjatë viteve të zbatimit të PKV të OGP	Lead: MAPA - DPAK		
			Supporting Stakeholders		
			Governme nt	CSOs	Others (e.g., Parliame nt, Private Sector etc)
2. Zhvillimi dhe zbatimi i instrumenteve për	Raporte vlerësimi (<i>corruption</i>)		DPAK ASPA Kuvendi KDIMDHP	IDM + OSHC të tjera	

vlerësimin e integritetit të legjislacionit dhe politikave publike (<i>corruption proofing</i>). 3. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në procesin e monitorimit të integritetit të vendimmarrjes publike dhe në vlerësimin e zbatimit të politikave. 4. Lobimi si instrument parandalimi dhe i lufts kundër korrupsionit 5. Rritja e transparencës së ndërveprimeve ndërmjet autoriteteve publike dhe grupeve të interesit, përmes publikimit të takimeve dhe informacionit mbi proceset e lobimit. 6. Përmirësimi i aksesit në informacion dhe të dhëna mbi proceset vendimmarrëse, përmes publikimit të tyre në format të hapur dhe të aksesueshëm për publikun.	<i>proofing</i>) të kryera Raporte periodike mbi integritetin e legjislacionit dhe vendimmarrjes publike Ngritja e regjistrit të lobimit; Aktivitete dhe informime për lobimin; Programi i transparenësë, i publikuar ; Raporte monitorimi dhe analiza të prodhuara nga OSHC.				
3.Zbatimi i kurrikulës së integritetit dhe rritja e informimit për luftën kundër korrupsionit, në institucionet e arsimit parauniversitar.					

1. Nisja nga zbatimi e kurrikulës së integritetit dhe edukimit kundër korrupsionit në arsimin parauniversitar. 2. Zhvillimi i materialeve didaktike dhe udhëzuesve për zbatimin e kurrikulës. 3. Trajnimi i mësuesve për zbatimin e kurrikulës së integritetit. 4. Organizimi i aktiviteteve ndërgjegjëse dhe edukative për integritetin dhe antikorrupsionin në shkolla. 6. Vlerësimi i ndikimit të kurrikulës në rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të nxënësve.	Kurrikulë e integritetit dhe edukimit kundër korrupsionit e miratuar dhe e integruar në sistemin arsimor parauniversitar; Materiale didaktike dhe udhëzues metodologjikë të zhvilluar për zbatimin e kurrikulës; Program trajnimi i strukturuar dhe i zbatuar për mësuesit; Aktivitete edukative dhe ndërgjegjëse të realizuara në shkolla (workshop-e, fushata, orë mësimore tematike); Raport vlerësimi mbi ndikimin e kurrikulës në njohuritë dhe ndërgjegjësimin e nxënësve.	Përgjatë viteve të zbatimit të PKV të OGP	Lead: Ministria e Arsimit - DPAK		
			<u>Supporting Stakeholders</u>		
			Government	CSOs	Others (e.g., Parliament, Private Sector etc)
			MA DPAK	IDM + OSHC të tjera	

Sfida e Qeverisjes së Hapur

Sfida e Qeverisjes së Hapur u lançua në vitin 2023 nga Komiteti Drejtues i OGP-së si një thirrje për veprim për të gjithë anëtarët e OGP-së për të rritur ambicien në dhjetë fusha të qeverisjes së hapur për të ndihmuar në forcimin e demokracive tona. Gjatë pesë viteve të ardhshme, të gjithë anëtarët e Partneritetit duhet të synojnë të rrisin ambicien e reformave në këto fusha dhe të demonstrojnë progres përkatës përmes planeve të tyre të veprimit të OGP-së ose më gjerë. Vendet mund të marrin pjesë në Sfidë duke plotësuar seksionin e mëposhtëm për të nominuar angazhime të pranueshme nga planet e tyre të veprimit. *Informacione të mëtejshme rreth Sfidës janë të disponueshme.*

DRAFT

Open Gov Challenge Submission

1. Do you want to submit this commitment to be considered for the Open Gov Challenge? <i>Challenge commitments should be the most ambitious, flagship commitments in the action plan. Not all commitments are expected to address the Challenge.</i>	Yes or No
2. Why does this commitment meet the ambition of the Challenge?	
3. What is the <i>primary</i> Challenge area? <i>A single commitment may address multiple Challenge areas.</i>	Select one of the following: 1. Qasja në Informacion 2. Antikorrupsioni 3. Hapësira Qytetare 4. Klima dhe Mjedisi 5. Qeverisja Digjitale 6. Hapja Fiskale 7. Gjinia dhe Përfshirja 8. Drejtësia 9. Liria e Medias 10. Pjesëmarrja Publike
4. What is the <i>secondary</i> Challenge area? <i>(if any)</i>	Select one of the following (if applicable): 1. Qasja në Informacion 2. Antikorrupsioni 3. Hapësira qytetare 4. Klima dhe Mjedisi 5. Qeverisja Digjitale 6. Hapja Fiskale 7. Gjinia dhe Përfshirja 8. Drejtësia 9. Liria e Medias 10. Pjesëmarrja Publike

DRAFT